

“PARTIA LEVIZJA PER ZHVILLIM KOMBETAR ”

AUDITIMI PASQYRAVE FINANCIARE

Per Periudhen 1 Janar- 31 Dhjetor 2015

Tirane 24 Nentor 2016

RAPORTI I AUDITUESIT

Partia Kristian Demokrate e Shqiptare

Bulevardi “Zogu I”, Pallati i Ruseve ,Kati Pare, Tirane

Kemi audituar Pasqyrat financiare bashkelidhur te **“Partise Levizja per Zhvillim Kombetar”** Tirane, te cilat perfshijne bilancin kontabel per ushtrimin e mbyllur me date 31 Dhjetor 2015, pasqyrat perkatese te te ardhurave dhe shpenzimeve, per kete ushtrim, si dhe nje permbledhje te metodave kontabel te rendesishme dhe shenime te tjera ne lidhje me to (anekse).

Pergatitja dhe paraqitja e sinqerte e ketyre pasqyrave financiare ne perputhje me Standartet Kombetare te Kontabilitetit eshte pergjegjesi e Drejtimit te partise. Kjo pergjegjesi perfshin: hartimin, venien ne zbatim dhe mbajtjen e kontrollit te brenshem te pershtatshem per pergatitjen dhe paraqitjen me sinqeritet te pasqyrave financiare qe jane pa anomali materiale, qofte per shkak te mashtrimit ose te gabimit; per te zgjedhur dhe zbatuar metodat e pershtatshme kontabel; si dhe per te bere çmuarjet kontabel qe jane te arsyeshme per rrethanat e dhena.

Pergjegjesia jone eshte qe, bazuar ne auditimin e kryer, te shprehim nje opinion mbi keto pasqyra financiare. Ne kemi kryer auditimin ne pajtim me Standartet Nderkombetare te Auditimit. Keto standarte kerkojne qe ne te zbatojme kerkesat etike dhe te planifikojme dhe kryejme auditimin tone per te mare sigurine e arsyeshme qe pasqyrat financiare nuk permbajne anomali materiale.

Auditimi perfshin ekzaminimin, mbi bazen e testeve, te evidences qe mbeshtet shumat dhe informacionet e dhena ne pasqyrat financiare. Procedurat e zgjedhura varen prej gjykimit te audituesit, duke perfshire vleresimin e rreziqeve per anomali materiale ne pasqyrat financiare, qofte per shkak te mashtrimit ose te gabimit. Ne berjen e ketyre vleresimeve te rrezikut, audituesi merr ne konsiderate kontrollin e brendshem perkates te shoqerise ne pergatitjen dhe paraqitjen me sinqeritet te pasqyrave financiare ne menyre qe te hartoje procedurat e auditimit qe jane te pershtatshme per rrethanat, por jo per qellimin e shprehjes se opinionit per efektiviten e kontrollit te brendshem te shoqerise. Auditimi perfshin gjithashtu, vleresimin e parimeve kontabel te perdorura dhe te llogjikun e çmuarjeve te rendesishme te bera nga Drejtimi, si dhe vleresimin e paraqitjes se pergjitheshme te pasqyrave financiare.

Ne besojme se evidenca e auditimit qe ne kemi marre eshte e mjaftueshme dhe e pershtatshme per te dhene bazat e opinionit tone te auditimit.



“LIRENG Auditing sh p k.

Sipas opinionit tone, pasqyrat financiare te pergatitura, me nje besueshmeri te aresyeshme japin nje pamje te vertete dhe te sinqerte per gjendjet financiare te **“Partise Levizja per Zhvillim Kombetar”** me 31 Dhjetor 2015, te rezultatit financiar dhe flukseve te parave per ushtrimin e mbyllur, ne perputhje me Ligji nr.8580, dt.17.02.2000 “Për partitë politike”, i ndryshuar dhe Ligjin 9228 date 29.04.2004 “Per Kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

“LIRENG Auditing” sh p k

Neshat MAZE



Tirane, me 24 Nentor 2016